

dialogu qeveridorë

Buletin Informativ – Shtator & Tetor, Botimi nr. 53

Përpjekje e përbashkët e Departamentit të Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj dhe Sekretariatit Teknik të Donatorëve

www.dsdc.gov.al

www.aidharmonisation.org.al



Foto: Koordinatorja e Përhershme e OKB-së, znj. Zineb Touimi-Benjelloun dhe Kryeministri i Shqipërisë, z. Sali Berisha gjatë ceremonisë së nënshkrimit të programit të ri të bashkëpunimit për periudhën 2012-2016

Qeveria shqiptare dhe Kombet e Bashkuara nënshkruajnë Programin e ri të Bashkëpunimit

Më 24 tetor 2011, Qeveria e Shqipërisë dhe Kombet e Bashkuara shënuan një hap të rëndësishëm përpara duke nënshkruar programin e ri të bashkëpunimit për periudhën 2012-2016. Programi i ri i kryesuar nga Qeveria shqiptare dhe i bazuar në pikat e forta të 20 agjencive pjesëmarrëse, programeve dhe fondeve të OKB-së, mbështet prioritetet kombëtare dhe sfidat zhvillimore të Shqipërisë në fushat e qeverisjes, shtetit të së drejtës, ekonomisë dhe mjedisit, zhvillimit rajonal e vendor dhe politikave të përfshirjes sociale. Programi mbështet Shqipërinë për të ecur përpara me Agjendën e saj të Integritimit European. Programi është fryt i konsultimeve të gjera me një sërë partnerësh si institucionet qendrore, shoqëria civile dhe shumë të tjera. Programi mbështetet te përvoja e fituar nga programi i mëparshëm Një OKB dhe thellon operacionet e OKB-së me qëllim që reformat t'i përgjigjen më me efikasitet prioritetëve kombëtare.

Gjatë fjalës së rastit, kryeministri i Shqipërisë, z. Sali Berisha, theksoi se: “Programi në pjesë vitet e ardhshme do të përqendrohet për të ndihmuar Shqipërinë në promovimin e një modeli për zhvillimin e qëndrueshëm.

‘Shqipëria, vend i zhvilluar’ është qëllimi madhor dhe ëndrra më e bukur e çdo shqiptari. Kemi të gjitha potencialet për të ndjekur këtë rrugë në interes të të gjithë shqiptarëve”.

Marrëveshjen e nënshkroi Ministri për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, z. Genc Pollo, i cili u shpreh se: Qeveria shqiptare e vlerëson veçanërisht vizionin e ri që ka sjellë nisma “Delivering as One”, që ka rritur koherencën dhe bashkëpunimin mes agjencive të OKB-së dhe homologëve kombëtare, duke garantuar zotërimin e plotë të qeverisë në zbatimin e kësaj nisme. Programi i ri është një kuadër gjithëpërfshirës i mbështetjes së OKB-së për prioritetet kombëtare të Shqipërisë dhe përfaqëson një hap përpara në procesin e reformave të OKB-së”. Znj. Zineb Touimi-Benjelloun e cila nënshkroi marrëveshjen në emër të OKB-së u shpreh se: “Programi pasqyron angazhimin e përbashkët për të arritur rezultate dhe për t'i shërbyer më mirë popullit shqiptar”.

Programi Një OKB në Shqipëri përfshin agjenci rezidente dhe jorezidente, fonde dhe programe të OKB-së që kontribuojnë strategjikisht për realizimin e prioritetëve zhvil-

limore të Shqipërisë, konkretisht: Fondi i OKB-së për Fëmijët (UNICEF), Programi për Zhvillim i OKB-së (UNDP), Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë (UNFPA), Programi i Përbashkët i OKB-së për HIV/AIDS (UNAIDS), Vullnetarët e OKB-së (UNV), Organizata e OKB-së për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave (UN Women), Komisioneri i Lartë për Refugjatët i OKB-së (UNHCR), Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO), Organizata Botërore e Shëndetësisë, Organizata Ndërkombëtare për Migrimin (IOM) dhe agjencitë jorezidente: Programi i OKB-së për Mjedisin (UNEP), Organizata e OKB-së për Arsim, Shkencë dhe Kulturë (UNESCO), Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë (FAO), Konferenca e OKB-së për Tregtinë dhe Zhvillimin (UNCTAD), Zyra e OKB-së kundër Drogës dhe Krimin (UNODC), Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë Atomike (IAEA), Fondi Ndërkombëtar për Zhvillimin Bujqësor (IFAD), Qendra Ndërkombëtare e Tregtisë (ITC), Organizata e OKB-së për Zhvillimin Industrial (UNIDO) dhe Komisioni Ekonomik i OKB-së për Evropën (UNECE).

Në këtë numër

- Qeveria shqiptare dhe Kombet e Bashkuara nënshkruajnë Programin e ri të Bashkëpunimit
- Qeveria shqiptare dhe SHBA festojnë suksesin e programeve të Pragut të Koorporatës së Sfidës së Mijëvjeçarit (MCC) në Shqipëri
- “UN Women” paraqet nismën e re globale për t’i dhënë fund dhunës ndaj grave
- “UN Women” sjell në Tiranë “Progresi i Grave në Botë”
- Konferencë për reformimin e sistemit të imuniteteve në Shqipëri: Rruga përpara
- Panairi “Punë dhe Studim”: Kooperacioni Italian kontribuon për Javën Europiane të NVM-ve
- Takimi prezantues i projektit të GLZ: Mbështetje për Zbatimin e Legjisacionit Shqiptar të përafuar me atë Evropian
- Qendra Kombëtare e Telemjekësisë krijon mundësi për kujdes më të mirë shëndetësor për zonat rurale
- Partneriteti Publik-Privat themelon të parën Qendër të Burimeve dhe Trajnimeve për TIK
- Ambasadorja Zvicerane dhe Ministri i Arsimit Përurojnë Mjediset e Reja të Shkollës Profesionale në Durrës
- Udhëheqës dhe Aktorë të Ardhshëm Politikë Diplomohen nga Shkolla Shqiptare e Studimeve Politike
- Të rinjtë kuksianë marrin Studime bazë për Punën
- Shkolla e Magjistraturës nis vitin e ri akademik me mbështetjen e OSBE-së
- BE dhuron mjete të reja lundruese për Policinë Kufitare dhe të Migracionit
- Plan Veprimi i ri për Emergjencat për pushtetin vendor të qarkut Shkodër
- Të mësosh për Buxhetimin Gjikor në Austri
- Festivali Ndërkombëtar i Filmit për të Drejtat e Njeriut
- Avokati i të Drejtave të Njeriut, z. Robert Badinter, viziton Shqipërinë për të analizuar sistemin e Drejtësisë për të Miturit, 12-14 tetor 2011
- Trajnim i personelit penitenciar për të miturit
- Panairi i Rrugës në Tiranë kremton 20-vjetorin e ringjalljes së miqësisë mes popullit të Shteteve të Bashkuara dhe të Shqipërisë
- Fotografi zviceran prezanton Librin dhe Ekspozitën me Fotografi për Tranzicionin e Shqipërisë në këto 20 vjet



■ Foto: Zgjerimi i qeverisjes elektronike në Shqipëri do të kërkojë rritjen e kapaciteteve të profesionistëve të TIK për të zbatuar dhe mbështetur sistemet e reja. Në foto, Drejtori i TIK në Qendrën Kombëtare të Licensimit, Edmond Pelushaj i shpjegon një kolegeje funksionimin e sistemit të ri të OKL.

Qeveria shqiptare dhe SHBA festojnë suksesin e programeve të Pragut të Koorporatës së Sfidës së Mijëvjeçarit (MCC) në Shqipëri

Më 21 tetor 2011, Programet I e II të Pragut të Sfidës së Mijëvjeçarit (MCC) asistuan qeverinë shqiptare për të ndërmarrë një sërë reformash me ndikim të madh, që synuan reduktimin e korrupsionit dhe informalitetit, si dhe përmirësimin e klimës së biznesit në Shqipëri. Në tetor, USAID dhe Qeveria shqiptare bashkëorganizuan ceremoninë për kremtimin e sukseseve të arritura nga zbatimi i këtyre programeve në Shqipëri. Ambasadori i SHBA-së në Shqipëri, z. Aleksandër Arvizu, Kryeministri z. Sali Berisha, si dhe Ministri për Inovacionin dhe TIK, z. Genc Pollo, mbajtën fjalën e tyre në këtë eveniment, ku vlerësuan kontributin e USAID-it dhe partneritetin me Qeverinë shqiptare dhe shoqërinë civile, që garantuan suksesin e programit. Në fjalën e tij,

Ambasadori Arvizu falënderoi Qeverinë shqiptare, organizatat e shoqërisë civile, si dhe komunitetin e biznesit, për kontributin e tyre në mbështetje të reformave për të forcuar shtetin e së drejtës, rritjen e transparencës si dhe përgjegjshmërinë në administratën publike në Shqipëri. Ambasadori gjithashtu theksoi se progresi i ardhshëm i Shqipërisë, veçanërisht drejt anëtarësimit në BE, do të bazohet në konsolidimin e përpjekjeve të qeverisë shqiptare për të luftuar korrupsionin dhe për forcimin e shtetit të së drejtës.

NË LIDHJE ME PROGRAMET E SHQIPËRISË NË MCC (2006-2011)

Projekti I i Shqipërisë, Pragu i Sfidës së Mijëvjeçarit (2006-2008) përbënte një marrëveshje me vlerë 13,85 milion USD ndërmjet Qeverisë së Shqipërisë dhe Koorporatës së Sfidës së Mijëvjeçarit të administruar nga USAID. Ky projekt ndihmoi qeverinë shqiptare në zbatimin e një sërë reformash me ndikim të lartë me synim reduktimin e korrupsionit dhe



■ Foto: USAID dhe Qeveria shqiptare bashkëorganizuan ceremoninë për kremtimin e sukseseve të arritura nga zbatimi i këtyre programeve në Shqipëri.

të informalitetit si dhe përmirësimin e klimës së biznesit në Shqipëri në këto fusha: Administrata Tatimore, Prokurimi Publik dhe Regjistrimi i Bizneseve. Projekti II i Shqipërisë, Pragu i Sfidës së Mijëvjeçarit (2009-2011) me vlerë 15,7 milion USD ishte në vijim të reformave në fushat e mëposhtme: Licencimi i Biznesit; Administrata Tatimore; Planifikimi Kombëtar i Territorit; Njësitë e Përbashkëta të Hetimit (zbatuar nga Zyra e Asistencës për Trainim dhe Zhvillim të Prokurorisë, OPDAT); Gjykata Administrative.

UN Women paraqet nismën e re globale për t'i dhënë fund dhunës ndaj grave

Shqipëria mund të bëhet vend “kampion” në luftën kundër dhunës në familje. Kështu ka pohuar znj. Maria José Alcalá, Këshilltare e Lartë dhe Drejtore e Seksionit për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave në UN Women, e cila vizitoi Tiranën më 28 tetor 2011, në një përpjekje për t'i paraqitur qeverisë dhe aktorëve të tjerë nismën më të re globale të shpallur në janar 2011 dhe të quajtur “Drejt Aksesit Universal: Shërbimet e Urgjencës në Përgjigje të Dhunës ndaj Grave dhe Vajzave. Znj. Alcalá mbajti disa takime me zyrtarë shqiptarë, përfshi Kryetaren e Kuvendit, znj. Jozefina Topallin, Ministrin e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, z. Spiro Ksera, zv. Ministrin e Brendshme, znj. Iva Zajmi dhe zv. Kryetaren e Bashkisë, znj. Jorida Tabaku. Ajo u takua edhe me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile dhe të donatorëve. “Ne jemi këtu për të lobuar me autoritetet vendore për paketën e shërbimeve të urgjencës të dhunës ndaj grave. Dhuna në familje është një fenomen



Foto: Këshilltarja e Lartë dhe Drejtorja e Seksionit për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave në UN Women, znj. Maria José Alcalá, gjatë takimit me Kryetaren e Parlamentit, Znj. Jozefina Topalli

pandemik dhe përgjigja duhet të jetë në të njëjtin nivel. Aksesit universal në shërbimet për gratë e abuzuara duhet të jetë prioritet në axhendën e qeverive në të gjithë botën, sepse dhuna në familje është një fenomen që nuk prek vetëm femrat, por edhe familjet, fëmijët, shoqërinë në përgjithësi edhe ekonominë”, - tha Alcalá.

Sipas një studimi, shtet anëtare të Këshillit të Evropës shpenzojnë rreth 33 miliard euro çdo vit për të luftuar dhunën në familje. Në të theksohet se, ndryshe nga ç'ndodh me mënyrën sesi trajtohen çështje të tjera të mëdha të zhvillimit si arsimit, vaksinat e fëmijëve, HIV dhe AIDS ose të vdekshmërisë amtare, ka pak ose aspak vende në botë që kanë plane kombëtare veprimi apo strategji që shprehin në mënyrë të qartë qëllimin për arritjen e aksesit universal ndaj shërbimeve për të gjitha gratë dhe vajzat që janë viktime apo të mbijetuarat të dhunës. Prandaj, kjo nismë i përgjigjet këtij boshllëku dhe synon të ofrojë orien-

tim dhe të mbështesë vendet “kampionë” që janë të angazhuar për ta ndërmarrë këtë përpjekje në 5 deri 10 vitet e ardhshme. Paketa propozon akses falas, universal dhe 24 orë në shërbimet kyçe të tilla si: edukimi i publikut për të drejtat juridike dhe si të aksesojnë në shërbime; linjat telefonike të urgjencës; siguria dhe mbrojtja imediate përmes reagimit policor dhe masave juridike; kujdesi shëndetësor, duke përfshirë edhe kujdesin pas përdhunimit; konsulencë dhe referimi; strehimi dhe akomodimi i sigurt; asistencë ligjore dhe dokumentimi i çështjeve.

Zyrtarët e qeverisë shqiptare e mirëpritën idenë që t'i bashkohen nismës dhe premtuan se do ta diskutojnë atë më tej në bashkëpunim të ngushtë me qeverisjen vendore. Në emër të Kuvendit, Kryetarja Topalli shprehu kënaqësinë për vizitën e ekipit të UN Women në Shqipëri: “Jemi të hapur për ta trajtuar dhunën ndaj grave si një problem të përbashkët dhe të gjejmë mënyrat për ta luftuar. Duhet të gjejmë të gjithë mekanizmat që ta çlirojmë gruan nga frika e denoncimit të çdo rasti dhune”. Ministri Ksera tha se: UN Women do të gjejë gjithmonë në Shqipëri një derë të hapur për çdo iniciativë”, ndërsa zv. Ministria Iva Zajmi theksoi vullnetin politik për të adresuar dhunën në familje si një prioritet. Bazuar në përvojën e luftës kundër trafikimit, znj. Zajmi vuri në dukje se: “ Nuk është e nevojshme për një vend të jetë i pasur për të gjetur zgjidhje për probleme të tilla. Mjafton një bashkëpunim i mirë i qeverisë, shoqërisë civile dhe biznesit për të kombinuar burimet, ekspertizën dhe fondet”.

Gjatë takimit me ekipin e UN Women, shumica e OJF-ve partnerë e përkrahën këtë këndvështrim, duke e konsideruar shumë të



Foto: Këshilltarja e Lartë dhe Drejtorja e Seksionit për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave në UN Women, znj. Maria José Alcalá, gjatë takimit me Ministrin Ksera

rëndësishëm krijimin e një mekanizmi për monitorimin dhe vlerësimin e mënyrës se si këto sistemeve funksionojnë rregullisht. Në Bashkinë e Tiranës ku sapo është krijuar Zyra për Barazinë Gjinore, zv. Kryetarja e Bashkisë, znj. Tabaku, paraqiti planet e bashkisë në fushën e shërbimeve sociale.

“Na ka bërë shumë përshtypje pritja shumë e mirë e autoriteteve shqiptare”, tha znj. Alcalá në mbyllje të vizitës në Tiranë. “Përveç vullnetit, ne vlerësojmë shumë seriozitetin e homologëve shqiptarë për të shqyrtuar pjesëmarrjen në këtë nismë globale”.

Për më tepër, Programi i ri i Bashkëpunimit (2012-2016) Shqipëri-OKB shërben si një mundësi ideale për të mbështetur përpjekjet e qeverisë në këtë drejtim, nëse Shqipëria vendos t'i bashkohet nismës dhe të bëhet vend kampion. UN Women do të vazhdojë të konsultohet dhe të kërkojë ndihmën e ekspertëve dhe të aktorëve kryesorë, përfshi qeverinë, lëvizjet e grave, organizatat e shoqërisë civile dhe Sistemin e OKB-së, me qëllim që të ndërtojë një bazë të gjerë partnerësh që shtrihet në rajone dhe disiplina të ndryshme, si edhe që të akumulojë standarde të cilësisë më të lartë dhe përvojë e dëshmi nga kontekste të ndryshme. Lançimi global i nismës nga “UN Women” pritet të bëhet nën një profil të lartë nga fundi i vitit 2012.

UN Women sjell në Tiranë “Progresi i Grave në Botë”

UN Women paraqiti raportin e parë “Progresi i Grave në Botë: Në kërkim të Drejtësisë 2011-2012” më 21 tetor në Tiranë, në prani të Kryetares së Kuvendit, znj. Jozefina Topalli, zv. Ministrit të Drejtësisë, z. Ermal Dobi, dhe zv. Ministres së Punës, znj. Filloreta Kodra. Kombet e Bashkuara përfaqësoheshin nga znj. Zineb Touimi-Benjelloun, Koordinatorja e Përhershme e OKB-së në Shqipëri. Në këtë eveniment prezantues morën pjesë deputetë të Kuvendit, ambasadorë, përfaqësues të Gjyqësorit, Shkollës së Magjistraturës, policisë, Komisionerit kundër Diskriminimit, organizatave të shoqërisë civile, organizatave ndërkombëtare dhe rajonale dhe media. “Progresi i Grave në Botë” është një vlerësim global 2-vjeçar që UN Women i bën ecurisë së barazisë gjinore që nga krijimi i organizatës në fillim të vitit 2010. Përmes statistikave, rasteve studimore dhe grafikës, raporti synon të frymëzojë qeverisë dhe shoqërinë civile të ndërmarrin veprime të vendosura që të përmbushin angazhimet e tyre dhe të përshpejtojnë arritjen e të drejtave të grave



Foto: UN Women paraqiti raportin e parë “Progresi i Grave në Botë: Në kërkim të Drejtësisë 2011-2012” më 21.10.2011 në Tiranë

në mbarë botën.

Në fjalën e saj, znj. Topalli theksoi nevojën për të zbatuar më mirë legjislacionin për të drejtat e grave. Ajo u shpreh se nuk është e lehtë të jesh grua në Shqipëri, por kjo është një arsyje më shumë që gratë të jenë në krye të drejtësisë, biznesit, medias dhe politikës. “Unë nuk mendoj se ne kemi një demokraci perfekte nëse ne nuk jemi të përfaqësuara drejt”, shtoi znj. Topalli. Koordinatorja e Përhershme e OKB-së në Shqipëri, znj. Touimi-Benjelloun, bëri një paraqitje të përpjekjeve të OKB-së në fushën e barazisë gjinore: “Krijimi i UN Women në vitin 2010 ishte rezultat i bindjes se problemet më komplekse të botës nuk mund të zgjidhen pa mençurinë dhe pjesëmarrjen e plotë të grave. Sfidat komplekse si konfliktet, ngrohja globale, migrimi, krizat pandemike apo financiare, zgjidhen vetëm me partneritete reale globale ku të dëgjohet zëri i burrave dhe grave”, tha znj. Touimi-Benjelloun said. Konstatimet e raportit i paraqiti znj. Semia Guermas de Tapia, Menaxhere e Programit të UN Women. Në prezantimin e saj, ajo theksoi se pavarësisht progresit, shpesh gratë përballen me padrejtësi, dhunë dhe pabarazi në shoqëri.

Zv.Ministri i Drejtësisë, z. Ermal Dobi, informoi të pranishmit për masat juridike për masat e qeverisë shqiptare për përmirësimin e aksesit në drejtësi për të gjithë qytetarët, përfshi gratë. Z. Dobi tha se gjatë vitit 2011, Strategjia ndërsektoriale e Sistemit të Drejtësisë është miratuar duke parashikuar në Planin e Veprimit angazhime specifike për barazinë gjinore, si dhe Ligji për Ndihmën Juridike është plotësuar me aktet nënligjore. Zv.Ministrja e Punës, znj. Filloreta Kodra, shtoi se ngritja dhe funksionimi i Qendrës Kombëtare për Rehabilitimin e Viktimave të Dhunës në Familje si dhe i Mekanizmit Kombëtar të Referimit në 17 bashki, ka dhënë ndikime pozitive për aksesin e grave në drejtësi, për shkak se

numri i denoncimeve të dhunës është rritur dhe gratë po marrin asistencë të specializuar nga institucionet e shtetit.

Gjatë debatit, përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile ngritën shqetësimin për sfidat specifike të grave që duan të kenë akses në drejtësinë shqiptare. Mes pengesave kryesore, ata përmendën trafishimin e tarifave për shërbimet gjyqësore, çka përbën një barrierë serioze për gratë që nuk mund t'i përballojnë, nevojën për kompensimin e avokatëve që ofrojnë konsulencë juridike për viktimat e dhunës në familje, instrumentet për të garantuar aksesin në drejtësi të grave me aftësi të kufizuara, mbushjen e boshllëqeve ligjore që bëjnë që gratë të kenë akses të kufizuar në të drejtat e pronësisë, sidomos në zonat rurale, si edhe nevojën për konsolidimin dhe përditësimin e statistikave për rastet e dhunës në familje, etj.

Duhet thënë që Shqipëria ka bërë hapa të rëndësishëm për të garantuar aksesin e grave në drejtësi, kryesisht përmes miratimit dhe/ose ndryshimit të disa ligjeve si: Ligji për Masat ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare (2007), Ligji për Barazinë Gjinore në Shoqëri (2008), ndryshimet në Kodin e ri Zgjedhor (2008), dhe Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi (2010). Ky kuadër ligjor ka mundësuar forcim të reagimit ndaj rasteve të dhunës në familje, rritje të kapaciteteve në gjykata, polici dhe institucione të tjera përgjegjëse, rritje të sensibilizimit dhe kërkesave të grave, si edhe përfshirje më të madhe të shoqërisë civile në dhënien e shërbimeve. Masat e fundit për të rritur praninë e grave në polici përbëjnë një hap të rëndësishëm drejt rritjes dhe reagimit adekuat ndaj nevojave të grave, përfshi gratë mbijetuese të dhunës. Aktualisht po bëhen përpjekje për të trajnuar gjyqtarët dhe avokatët në lidhje me legjislacionin ndërkombëtar, rajonal dhe të brendshëm për të drejtat e grave.

Konferencë për reformimin e sistemit të imuniteteve në Shqipëri: Rruga përpara

Një konferencë e nivelit të lartë mbi reformën e imuniteteve në Shqipëri u zhvillua më 18 tetor 2011 në Tiranë, me pjesëmarrjen e Presidentit të Republikës, autoriteteve të nivelit të lartë ekzekutiv, anëtarëve të Parlamentit, të gjyqësorit, ekspertëve ndërkombëtarë dhe shoqërisë civile. Konferenca u organizua nga dy nismat e financuara prej BE-së, 'Projekti për Anti-Korrupsion në Shqipëri' (PACA) dhe 'Projekti i Konsolidimit të Sistemit të Drejtësisë' (EURALIUS), nisma këto që që të dyja propozojnë ngushtimin e imunitetit të zyrtarëve të zgjedhur dhe gjyqtarëve në Shqipëri. Imunitetet e zyrtarëve të zgjedhur dhe gjyqtarëve qëndrojnë në themel të reformave të nevojshme për të forcuar sundimin e ligjit dhe luftën kundër korrupsionit në Shqipëri, dhe në këtë mënyrë për-



Foto: Konferenca për reformimin e sistemit të imuniteteve në Shqipëri: Rruga përpara, organizuar më 18 tetor 2011

forcojnë përpjekjet e Shqipërisë për pranimin në BE, por edhe reputacionin e vendit, zhvillimin e saj ekonomik dhe për cilësinë e qeverisjes së qytetarëve shqiptarë.

Ekspertët e BE-së dhe Këshillit të Evropës paraqitën në konferencë rekomandi-

met e tyre në lidhje me se si të reformohet regjimi i imuniteteve në përputhje me standardet dhe praktikatat më të mira evropiane dhe ndërkombëtare, të cilat duhet të çojnë në formulimin e një politike të qeverisë shqiptare për këtë çështje. Rekomandi-

Panairi "Punë dhe Studim": Kooperacioni Italian kontribuon për Javën Evropiane të NVM-ve

Nga 7-9 tetor 2011, Kooperacioni Italian për Zhvillim mori pjesë në Panairin "Punë dhe Studim" të organizuar në Pallatin e Kongreseve në Tiranë, në kuadrin e Javës Evropiane të Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme, promovuar nga Drejtoria e Përgjithshme për Ndërmarrjet dhe Industrinë e Komisionit Evropian. Gjatë javës që përfshin 3-9 tetori, në 37 shtete evropiane u organizua një numër i konsiderueshëm konferencash, seminarësh dhe ditësh informuese, me qëllim që të shpalosen programet e Bashkimit Evropian në mbështetje të Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme, si edhe nismat kombëtare dhe vendore në favor të zhvillimit të sektorit privat. Synimi i Bashkimit Evropian është promovimi i sipërmarrjes tek gjeneratat e reja, evidentimi i historive të suksesshme dhe nxjerrja në pah e rolit drejtues që sipërmarrja individuale sjell në zhvillimin social-ekonomik të shoqërive evropiane. Në linjë me propozimet e përgjithshme të Javës Evropiane për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme, panairi pati si qëllim promovimin e shpirtit dhe kulturës sipërmarrëse shqiptare, duke i kushtuar vëmendje të veçantë aktiviteteve didaktike të realizuara nga universitetet dhe institucionet trajnuese për të lehtësuar aksesin e të rinjve në tregun e punës, e sidomos në sektorin privat. Si rrjedhojë, një numër institucionesh shqiptare, ministri të linjës, universitete, qendra të formimit profesional, dhoma të tregtisë, shoqata tregtare, shoqata biznesi dhe qendra punësimi, prezantuan përpjekjet e tyre në mbështetje të projekteve novatore të biznesit.

Kooperacioni Italian për Zhvillim, i ftuar

shprehimisht nga METE si Donatori Kryesor Evropian për zhvillimin e sektorit privat, përgatiti një pavijon ekspozues në bashkëpunim me METE, AIDA (Agjensia Shqiptare për Zhvillimin e Investimeve), QKR (Qendra Kombëtare e Regjistrimit të Biznesit) dhe QKL (Qendra Kombëtare e Licencimit). Ky pavijon ofroi ndër të tjera, të gjitha informacionet përkatëse rreth Programit Italo-Shqiptar për mbështetjen e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme dhe mundësitë që dalin nga ky program për sa i kërket kredive të buta për projektet e biznesit të vogël. Panairi u hap me përshëndetjet nga ana e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Nasip Naco, Kreut të Delegacionit të BE-së, Ettore Sequi, dhe Ambasadorit Italian, Saba D'Elia. Në panair ishin të pranishëm edhe zv.Ministria e Arsimit, Nora Malaj, dhe zv.Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Filloreta Kodra.

Kooperacioni Italian organizoi një prezantim nga Profesori Italian, z. Mario Petrone (Universiteti i Molises) mbi lidhjet ndërmjet institucioneve akademike dhe tregut të punës. Ai gjithashtu prezantoi AlmaLaurea (www.alma laurea.it), një bazë të dhënash/shërbim novator online italian që grumbullon jetëshkrimet e të diplomuarve për t'u konsultuar nga punëdhënësit në Itali dhe Evropë.

Kooperacioni Italian dhe Profesor Petrone shprehën dëshirën që universitetet dhe studentët e rinj të mund të përfitojnë nga instrumentet e reja të TIK-ut si AlmaLaurea. Për këtë qëllim, ka filluar dialogu me institucionet akademike përkatëse në Shqipëri.



Foto: Pavijoni ekspozues i Kooperacionit Italian për Zhvillim



Foto: Drejtori i Dhomës së Tregtisë, Nikolin Jaka, Ambasadori Italian në Tiranë, Saba D'Elia, zv.Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Filloreta Kodra, Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Filloreta Kodra, Spiro Ksera, Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Nasip Naco, zv.Ministria e Arsimit, Nora Malaj dhe Shefi i Delegacionit të BE-së, Ettore Sequi



Foto: Drejtori i Kooperacionit Italian për Zhvillim, Aldo Sicignano, dhe Profesor Mario Petrone

met kryesore janë për ndryshimin e Kush-tetutës së Shqipërisë në mënyrë që të hiqet imuniteti i deputetëve dhe gjyqtarëve ndaj ndjekjes për procedurë penale, dhe vetëm të ruajnë vetëm mosmbajtjen e përgjegjë-sisë për mendimet dhe votat e shprehura, së bashku me imunitetin ndaj arrestimit dhe kërkimit.

Ambasadori Ettore Sequi, Shefi i Dele-gacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri tha: ‘Konkluzionet e Raportit të Progresit Vjetor 2011 të Komisionit Evropian për Shqipërinë të bërë publik javën e kaluar tregojnë qartë se “është bërë progres i kufi-zuar në fushën e politikës anti-korrupsion, e cila është një prioritet kyç i Opinonit.’. Ambasadori Sequi shtoi se: “Angazhimi i fortë politik në nivelet më të larta dhe një marrëveshje e gjërë mes forcave politike është një kusht i domosdoshëm për perparimin drejt BE-së, veçanërisht në fushën e sundimit të ligjit.”

EURALIUS është një projekt 30-mujor i financuar nga Bashkimi Evropian i cili ka filluar në shtator të vitit 2010 me qëllim që të përafrojë sistemin shqiptar të drejtësisë në përputhje me standardet e BE-së të transparencës, efikasitetit dhe pavarësisë. Projekti vihet në zbatim nga Ministria Spanjolle e Drejtësisë së bashku me Këshillin e Lartë të Magjistraturës Italiane dhe ka një buxhet prej 2.3milionë €uro. PACA është një projekt 30-mujor i cili ka filluar në shtator 2009 me qëllim përmirësimin e zbatimit të politikave anti-korrupsion në Shqipëri në përputhje me standardet dhe praktikatat më të mira Evropiane dhe ndërkombëtare. Kryesisht ajo është financuar nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Keshilli i Evropës nëpërmjet një buxheti prej 2.1milionë €uro.



Foto: Takimi prezantues i projektit dyvjeçar të GIZ “Mbështetje për Zbatimin e Legjislacionit Shqiptar të Përafuar me atë Evropian.

GIZ fillon një projekt të ri për të mbështetur zbatimin e legjisacionit

Më 20 tetor 2011 u zhvillua takimi prezantues i projektit dyvjeçar “Mbështetje për Zbatimin e Legjislacionit Shqiptar të Përafuar me atë Evropian. Takimin e zhvilluar në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, e hapën zv. Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Enno Bozdo, zv.Ambasadori i Republikës Federale Gjermane, Eric Tintrup dhe Drejtori i ri i Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, Martin Marschke. Zv.Ministri theksoi rëndësinë e procesit të anëtarësimit në BE në përgjithësi, dhe vullnetin e Shqipërisë për të ecur në rrugën evropiane. Në këtë drejtim, projekti mund të luajë rol vendimtar. Zv. Ambasadori Gjerman konfirmoi gatishmërinë e

Gjermanisë që e ka mbështetur Shqipërinë deri tani, ndërsa Drejtori i GIZ-it tha se është e rëndësishme që METE është partner strategjik prej disa vitesh. Më pas, projekti u prezantua nga Blerina Raca, menaxhere e projektit. Objektivi i përgjithshëm është mbështetja e përafërimit ligjor me *acquis* të BE-së në fushën ekonomike me të drejtën e tregut unik të BE-së, konkretisht me 8 kapitujt për të cilat METE është institucion drejtues: Kapitulli 1 (Lëvizja e lirë e mallrave), Kapitulli 3 (E drejta e vendsjes dhe liria për të ofruar shërbime), Kapitulli 6 (E drejta e shoqërive tregtare), Kapitulli 7 (E drejta e pronësisë intelektuale), Kapitulli 15 (Energjia), Kapitulli 20 (Ndërmarrjet dhe politika industriale), Kapitulli 28 (Konsumatori dhe mbrojtja e Shëndetit) dhe Kapitulli 30 (Marrëdhëniet me jashtë). Mbështetja do të jepet në disa drejtime: p.sh. në konsulencë juridike nga ekspertë vendas dhe të huaj (analizat e mangësive ligjore, hartimi i legjislacionit, praktikatat më të mira, etj.), trajnimi i aftësive metodike, forcimi i kapaciteteve dhe zhvillimi organizativ, mbështetje për zbatimin e *acquis*, bashkëpunimi rajonal me vendet fqinje, përdorimi i rrjeteve dhe forumeve ekzistuese. Projekti e ka filluar tashmë punën me mbështetje ligjhartuese në fushën e bashkimeve ndërkufitare të shoqërive tregtare dhe Kodin e Qeverisjes së Korporatave.

Qendra Kombëtare e Telemjekësisë krijon mundësi për kujdes më të mirë shëndetësor për zonat rurale

Në shtator, në prani të Ambasadorit të SHBA Aleksandër Arvizu, dhe Kryeministrit të Shqipërisë Sali Berisha, u hap zyrtar-



Foto: Ambasadori i SHBA, Aleksandër Arvizu, dhe Kryeministri Sali Berisha, inaugurojnë Qendrën Kombëtare të Telemjekësisë në Spitalin Universitar “Nënë Tereza” në Tiranë

isht Qendra Kombëtare e Telemjekësisë në Spitalin Universitar “Nënë Tereza” në Tiranë. Qendra do të shërbejë si bazë për telemjekësinë në nivel kombëtar dhe për rrjetin e shëndetësisë elektronike në Shqipëri, që do të ndikojë drejtpërdrejt tek aksesin në shërbimin shëndetësor në zonat rurale, kujdesin për pacientin, si dhe tek edukimi mjekësor për profesionistët e shëndetësisë. Përveç Qendrës Kombëtare të Telemjekësisë, USAID po financoi ngritjen e pesë Qendrave Racionale të Telemjekësisë (Kukës, Shkodër, Durrës, Korçë dhe Vlorë). Zyra e SHBA për Bashkëpunim Ushtarak (ODC) në Tiranë po rinovon objektet ku janë hapur këto qendra. Këto qendra kanë kapacitet për t'u lidhur në mënyrë elektronike me spitalet dhe universitetet mjekësore nëpër botë, duke përfshirë tre në Shtetet e Bashkuara, përkatësisht Universiteti i Arizonës, Shkolla e Mjekësisë “Pritzker” në Universitetin e Çikagos, dhe Kolegji i Mjekësisë Osteopate “Edward Via” në Virxhinia.

Partneriteti Publik-Privat themelon të parën Qendër të Burimeve dhe Trajnimeve për TIK

Në tetor, në ceremoninë e zhvilluar në ambientet e Ministrisë së Inovacionit dhe TIK-ut u krijua zyrtarisht aleanca mes Fondacionit Shqiptaro-Amerikan për Zhvillimin (AADF), Qeverisë Shqiptare, USAID-it, Microsoft Albania, Hewlett-Packard, Cisco dhe Albtelecom. Ky partneritet publik-privat do të krijojë të parën Qendër të Burimeve dhe Trajnimeve për TIK në Shqipëri, PROTİK, e cila do të mbështetë zhvillimin dhe përdorimin e novacionit të TIK-ut për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme,




Foto: Kryetari i Bordit të Fondacionit Shqiptaro-Amerikan për Zhvillimin, z. Michael Granoff, nënshkruan Memorandumin e Mirëkuptimit për Ngritjen e të parës Qendrës së Burimeve dhe Trajnimeve për Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit në Shqipëri, PROTİK

si dhe do të nxisë rritjen e TIK-ut në Shqipëri. Qendra do të funksionojë si organizatë e pavarur jofitimprurëse, e modeluar sipas disa Qendrave të Inovacionit në fushën e TIK-ut në vende si Kroacia, Armenia e vende të tjera evropiane. Misioni i saj është të shërbejë si katalizator për zhvillimin e industrisë së TIK-ut në Shqipëri duke nxitur novacionin, sipërmarrjen, duke rritur kërkesën për TIK dhe duke nxitur formimin e partneriteteve. Qendra PROTİK pritet të hapet në pranverën e vitit 2012.

Ambasadorja Zvicerane dhe Ministri i Arsimit Përurojnë Mjediset e Reja të Shkollës Profesionale në Durrës

Më 20 shtator 2011, Ambasadorja zvicerane Shkëlqesia e Saj Yvana Enzler dhe Ministri i Arsimit dhe Shkencës, z. My-

qerem Tafaj, përurojnë dy klasa të reja në shkollën profesionale “Beqir Çela” në Durrës. “Kjo shkollë profesionale me reparatet e praktikës dhe me një kurrikul të përditësuar, përbën një prej shembujve tanë të forcimit të arsimit profesional në vend”, tha Ambasadorja Enzler, ndërkohë që u kujtoi të pranishmëve se formimi profesional i përgatit të rinjtë për punësim, pavarësi financiare dhe për një të ardhme më të mirë. Ministri Tafaj theksoi se “qeveritë shqiptare dhe zvicerane kanë pasur prej kohësh një bashkëpunim të mirë dhe një shembull i këtij ka qenë shkolla “Beqir Çela” e cila pasqyron një formë të re të arsimit dhe të përgatitjes së të rinjve përtë ardhmen e tyre profesionale”. Ministri gjithashtu përmendi se qëllimi si për qeverinë dhe për donatorët zviceranë ishte që “ta bënin arsimin më të pajtueshëm me kërkesat e tregut dhe që të ngjeshin standardet e arsimit në nivelet evropiane”. Evenimenti u zhvillua në kuadrin e vizitës së nivelit të lartë të z. Kurt Kunz, Drejtor i Bashkëpunimit me Evropën Lindore për SDC-në, Agjencinë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim. SDC financoi rehabilitimin e shkollës “Beqir Çela” përmes Projektit AlbVet, i zbatuar nga Swisscontact. “Unë jam krenar që shikoj sot që një institucion që ne mbështetëm, është ngritur dhe po funksionon duke përgatitur të rinjtë për një punësim të ardhshëm”, tha z. Kunz. “Është vendimtare që të rinjtë të kenë një perspektivë të jetës së tyre, dhe për shoqërinë është e rëndësishme të ketë profesionistë të kualifikuar për shërbimet. Shqipëria do të përfitojë nga rakordimi më i mirë ndërmjet arsimit profesional dhe kërkesave të tregut të punës”.

Falë financimit dhe ekspertizës zvicerane, shkolla ka kurrikula dhe klasa të standardeve të larta, të pajisura me makineri, modele, projektorë dhe kompjutera. Në



Foto: Z. Kurt Kunz, Drejtor i Bashkëpunimit me Evropën Lindore për SDC-në, përshëndet dhe takohet me studentët e shkollës profesionale “Beqir Çela” në Durrës. Shkolla e rinovuar me mbështetjen e Bashkëpunimit Zviceran, konsiderohet shembull i shkëlqyer i arsimit profesional në Shqipëri

të gjithë shkollën ka lidhje interneti dhe dy klasat e përruara sot do të shërbejnë për të mësim në fushën e IT. Nxënësit që diplomon kjo shkollë e kanë më të lehtë për të gjetur punë për shkak të marrëdhënieve të qëndrueshme dhe reputacionit të mirë të shkollës tek komuniteti i biznesit.

Udhëheqës dhe Aktorë të Ardhshëm Politikë Diplomohen nga Shkolla Shqiptare e Studimeve Politike

Shkolla Shqiptare e Studimeve Politike u dha diploma brezi të ri të studentëve që përfunduan kursin njëvjeçar. Gjatë një ceremonie diplomimi më 20 tetor 2011, Shkolla Shqiptare e Studimeve Politike (ASPS) shpërndau diploma për 23 studentët që përfunduan me sukses një periudhë njëvjeçare studimi. Në praninë e Presidentit të Republikës, z. Bamir Topi, Ambasadores Zvicerane, Znj. Yvana Enzler dhe Kreut të Këshillit të Europës në Shqipëri, z. Marco Leidekker, stafi i ASPS dha diplomat, përgëzoi të sapodiplomuarit dhe bëri thirrje për vazhdimin e mbështetjes ndaj shkollës. Në ceremoni morën pjesë edhe përfaqësues të institucioneve shtetërore, partive politike, ambasadave dhe misioneve diplomatike, shoqërisë civile etj. Ceremonia u transmetua live nga një televizion lokal, si dhe në edicionet e lajmeve të televizioneve kryesore, përfshi ato kombëtare. “Është thelbësore të përgatiten, trajnohen, dhe të diplomohen udhëheqësit, administratorët dhe ligjvënësit e ardhshëm të cilët po punojnë ose do të punojnë në një të ardhme në sferën publike”, tha Ambasadorja zvicerane. “Shkolla Shqiptare e Studimeve Politike ka arritur të ketë sukses dhe pas pesë vitesh ne mund të themi



Foto: Presidenti Topi dhe Ambasadorja zvicerane me studentët e diplomuar nga Shkolla Shqiptare e Studimeve Politike.

me plot gojën që është krijuar një traditë e re”, tha Presidenti Topi. Më pas Presidenti gjithashtu u shpërndau diplomat studentëve gjatë ceremonisë së diplomimit. Shkolla Shqiptare e Studimeve Politike u themelua nga Këshilli i Evropës dhe aktualisht mbështetet nga Zyra e Bashkëpunimit Zviceran në Shqipëri. Mbështetja Zvicerane e mundësoi Shkollën që të rrisë numrin e kurseve nga 3 në 5 si dhe të përfshijë qeverisjen vendore dhe rajonale si modul të veçantë. Çdo vit, një brez i ri politikanësh dhe aktorësh të cilët punojnë ose aspirojnë të punojnë në funksione publike, hyjnë në shkollë dhe diplomohen. ASPS synon elitën dhe kërkon të fusë vlerat e dialogut, transparencës dhe konsensusit midis udhëheqjes së ardhshme politike.

Të rinjtë kuksianë marrin Studime bazë për Punën

Kukës, 7 tetor 2011 - 57 të rinj nga Kukësi përfunduan një kurs 4-mujor për Studimet Bazë për Punën të kryer nga qendra Don Bosco dhe të mbështetur nga UNICEF në kuadrin e programit të për-

bashkët të OKB-së për Rininë, Punësimin dhe Migrimin. Kursi është një paketë aftësish profesionale dhe për jetën, që u mundëson të rinjve të jenë më të përgatitur për të hyrë në tregun e punës. Përfaqësuesi i UNICEF-it, z. Detlef Palm, falënderoi zyrtarët e Kukësit, të Shërbimeve të Punësimin dhe të Qendrës Don Bosco për angazhimin e tyre dhe falënderoi veçanërisht vajzat që përbënin shumicën e kursantëve. “Gjatë këtij kursi, keni mësuar për etikën në punë, kontabilitetin bazë, aftësitë e komunikimit dhe mbi të gjitha, të drejtën tuaj për punë. Ky nuk është fundi i rrugës, por vetëm fillimi. Përdorni njohuritë e fituara që të merrni në dorën jetën tuaj”, u tha z. Palm të rinjve kuksianë. Programi i përbashkët i ka dhënë asistencë edhe Shërbimit Kombëtar të Punësimin për ngritjen e qendrave të punësimin që kanë në qendër të vëmendjes rininë.

Shkolla e Magjistraturës nis vitin e ri akademik me mbështetjen e OSBE-së

Shkolla e Magjistraturës organizoi më 3 tetor 2011 një ceremoni me rastin e fillimit të vitit të ri akademik për studentët e saj ekzistues dhe 17 studentët e rinj, të cilët do të bëhen gjykatës dhe prokurorë në fund të trajnimit trevjeçar. Për vitine dytë radhazi, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri mbikëqyri procesin e provimit të pranimit, që filloi nga testimi me shkrim i 244 kandidatëve, deri në shpalljen e rezultateve.

Duke iu drejtuar të pranishmëve, Kryetari i Prezençës, Ambasadori Eugen Wollfarth, theksoi rëndësinë që ka Shkolla e Magjistraturës në përgatitjen e profesionistëve të ardhshëm të sistemit gjyqësor, si dhe bashkëpunimin afatgjatë midis Prezençës dhe Shkollës. “Në këndvështrimin tim, Shkolla e Magjistraturës siguron themelet më të qëndrueshme për një sistem drejtësie të efektshëm dhe transpar-



Foto: 57 të rinj nga Kukësi përfunduan një kurs 4-mujor për Studimet Bazë për Punën të kryer nga qendra Don Bosco dhe të mbështetur nga UNICEF në kuadrin e programit të përbashkët të OKB-së për Rininë, Punësimin dhe Migrimin

ent në Shqipëri. Kjo është vendimtare në dërtimin e një sektori drejtësie cilësor dhe funksional. Prezenca e OSBE-së ka qenë vëzhguese dhe mbështetëse e interesuar në procesin e përzgjedhjes së “gurëve” për ndërtimin e këtyre themeleve, përmes monitorimit të procesit të provimeve të pranimit”, tha ai. Drejtorja e Shkollës së Magjistraturës, Mariana Semini, tha se qëllimi i shkollës është të përgatitë gjykatës dhe prokurorë profesionistë që respektojnë parimet e pavarësisë dhe paanësisë.

Krahas ndihmës në përzgjedhjen e studentëve të rinj, Prezenca, në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës, ka organizuar edhe seminare trajnimi të specializuara për gjykatës e prokurorë. Pjesa më e madhe e tyre kanë pasur në fokus Shërbimin e ri të Provës dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, dy fusha në të cilat Prezenca ka qenë e përfshirë në mënyrë aktive.

USAID promovon Ndërmjetësimin si Alternativë ndaj Gjyqit në Shqipëri

Në tetor, Programi i USAID-it për Forcimin e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri (JuST), në bashkëpunim me Fondacionin shqiptar “Zgjidhja e Konfliktëve dhe Pajtimi i Mosmarrëveshjeve” (FZK), mbajti të parën nga tri tryezat e rrumbullakëta në Korçë, me përfaqësues nga Dhoma Rajonale e Avokatisë, nga biznesi dhe shoqëria civile, për të inkurajuar përdorimin e ndërmjetësimit, si alternativë jashtëgjyqësore më e shpejtë dhe më pak e kushtueshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve mes palëve.

Kjo fushatë promovuese vjen pas një fushate ndërgjegjësimi të publikut e prezantuar në shtator me moton: “Zgjidhja e mosmarrëveshjeve tregtare dhe familjare me ndërmjetësim - Një zgjedhje që nxjerr të gjithë të fituar!”. Në qershor, USAID dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë bënë të mundur ngritjen e Qendrës së Ndërmjetësimit pranë kësaj gjykate, ku ndërmjetës të FZK-së ofrojnë shërbime të ndërmjetësimit për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me karakter familjar dhe tregtar. USAID po mbështet edhe Qendrën e Ndërmjetësimit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe synon të mbështesë ngritjen dhe funksionimin e një qendre të tretë të ndërmjetësimit, duke ndihmuar kështu në reduktimin e ngarkesës së çështjeve dhe në rritjen e efektshmërisë në gjykata.



Foto: Drejtoresha e Bashkëpunimit Zviceran, znj. Isabel Perich, bashkë me Drejtorin e Qendrës Rajonale të Mjedisit, z. Mihallaq Qirjo dhe përfaqësues të pushtetit vendor, gjatë prezantimit të planit të ri të veprimit për emergjencat dhe gatishmërinë ndaj fatkeqësive për qarkun Shkodër.

Plan Veprimi i ri për Emergjencat për pushtetin vendor të qarkut Shkodër

Bashkëpunimi Zviceran dhe Qendra Rajonale e Mjedisit njoftuan se një plan i ri veprimi për emergjencat dhe gatishmërinë ndaj fatkeqësive është gati për qarkun e Shkodrës. Këto ndërhyrje parashikojnë edhe ndërtimin e brezave mbrojtës përreth katër stacioneve të furnizimit me ujë.

Gjatë një konference më 4 tetor 2011, Zyra e Bashkëpunimit Zviceran në Shqipëri dhe Qendra Rajonale e Mjedisit njoftuan përfundimin e një plan veprimi për emergjencat dhe gatishmërinë ndaj fatkeqësive, i cili synon parandalimin dhe menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet në qarkun Shkodër, ku përfitojnë rreth 86,000 qytetarë. Konferenca u zhvillua tek “Hotel Colosseum” në Shkodër me pjesëmarrës nga Zyra e Bashkëpunimit Zviceran në Shqipëri, Ministria e Mjedisit, Ministria e Brendshme, Qendra Rajonale e Mjedisit dhe institucionet vendore dhe rajonale. “Unë besoj se kemi hedhur një hap të mirë përpara në gatishmërinë ndaj situatave të emergjencës, në forcimin e kapaciteteve të komunave dhe bashkive për përballimin e fatkeqësive dhe në dërgjegjësimin e popullatës për rreziqet e mundshme dhe si t’i përballojmë ato”, tha Drejtoresha e Bashkëpunimit Zviceran, Znj. Isabel Perich. Konferencën e drejtorit Drejtorit i Qendrës Rajonale të Mjedisit në Shqipëri, z. Mihallaq Qirjo, ndërsa moderatorë të tjerë shpjeguan përfitimet për komunitetet e pushtetit vendor, si dhe prezantuan efektet e pritshme në disa komuna të rrezikuara nga përmbytjet. Pjesë e projektit është edhe një fushatë ndërgjegjësimi që synon të informojë popullatën vendore mbi rreziqet,

parandalimin dhe menaxhimin e fatkeqësive.

Asistenca zvicerane për këtë projekt ishte mbi 80,000 € dhe përfshinte një mision faktmbledhës që dha rekomandime për përmirësimin e cilësisë dhe vazhdimësinë e furnizimit me ujë të pijshëm, si edhe për nevojën e një plani veprimi për emergjencat. Një rezultat i rëndësishëm i këtij projekti është ndërtimi i brezave mbrojtës në 4 stacione të pompimit të ujit në tri komuna të Shkodrës. Kjo bën që furnizimi me ujë të jetë i sigurt dhe i pastër për rreth 12,000 banorë në raste krize nga përmbytjet.

BE dhuron mjete të reja lundruese për Policinë Kufitare dhe të Migracionit

Ceremonia e dhurimit të 7 mjeteve të reja lundruese Policisë Kufitare dhe Migracionit, të financuar nga BE-ja, dhe përirimi i godinës së re të Njësisë Delta Forcë të financuar nga Qeveria Shqiptare, u organizua në Rradhimë të Vlorës, më 7 tetor 2011. Në këtë eveniment ishin të pranishëm Kryeministri i Shqipërisë z. Sali Berisha, Ambasadori i BE-së në Shqipëri, z. Ettore Sequi, Ministri i Brendshëm z. Bujar Nishani, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit z. Hysni Burgaj, drejtues të tjerë të lartë të Policisë së Shtetit, diplomatë të vendeve të BE-së, përfaqësues të Misionit PAMECA III, përfaqësues të pushtetit vendor dhe efektivë nga njësitë operacionale të Policisë Kufitare dhe Migracionit në Vlorë.

Kryeministri z. Sali Berisha u shprehur mirënjohjen vendeve të BE-së për mbështetjen e nëpërmjet Komisionit Evropian në Shqipëri dhe siguroi pjesëmarrësit që kjo mbështetje do të shfrytëzohet

me profesionalizëm dhe efikasitet, me qëllim që ujjat territorialë të jenë më të sigurtë. Ai tha që këta 7 mjete lundruese të dhuruara nga BE-ja, janë të një teknologjie bashkëkohore, të pajisura me të gjitha mjetet e nevojshme për një kontroll më të mirë dhe më efikas të bregdetit shqiptar. Ai falenderoi Policinë e Kufitare dhe Migracionit për punën e mirë të bërë me kontrollin e kufirit, duke kontribuar kështu në liberalizimin e vizave. Ministri i Brendshëm, z. Nishani, përmendi disa rezultate inkurajuese të arritura nga Policia e Shtetit në luftën kundër trafikëve. Ai raportoi që trafikimi i heroinës nga 1100 kg në vitin 2004, është ulur në 10 kg në tre vitet e fundit. Respekti i treguar nga shqiptarët për lëvizjen e lirë është më i miri në rajon, shtoi ai. Ai shprehu respektin e tij më të lartë për punonjësit e Policisë Kufitare dhe Migracionit dhe për bashkëpunimin e tyre të shkëlqyer me agjencitë ligjvënese të vendeve mike, i cili konsiderohet një bashkëpunim i domosdoshëm në luftën e suksesshme kundër korrupsionit. Ambasadori i BE-së në Shqipëri, z. Ettore Sequi, tha që BE-ja e mbajti premtimin e saj. Ai vlerësoi mbështetjen e ofruar për Policinë e Shtetit dhe premtoi që mbështetja do të vazhdojë edhe në të ardhmen. Ai theksoi të gjitha arritjet e Shqipërisë në kontrollin e kufirit dhe në luftën kundër trafikëve, të cilat gjithashtu përbëjnë sfida ndërkombëtare. Ai tha që liberalizimi i vizave tregoi përmirësim të standardeve në mbrojtjen e kufirit të gjelbër dhe blu. Këto janë arsye që BE-ja, siç ka bërë deri më tani, do të vazhdojë të mbështesë Shqipërinë edhe në të ardhmen. Megjithatë për të arritur këtë dhe në mënyrë që kjo mbështetje të jetë e qëndrueshme, kërkohet edhe vendosmëria e autoriteteve shqiptare. Në fund të ceremonisë, pjesëmarrësit vëzhguan nga afër mjetet e reja lundruese dhe vizituan godinën e re të Njësisë Delta Force.



Foto: Ceremonia e dhurimit të 7 mjeteve të reja lundruese Policisë Kufitare dhe Migracionit, të financuar nga BE-ja, dhe përirimi i godinës së re të Njësisë Delta Forcë të financuar nga Ceveria Shqiptare



Mbështetje Barazisë Gjinore në Policinë e Shtetit

Flamuri shqiptar u valëvit për herë të dytë në Paradën e Kombeve të Konferencës së 49-të të Trajnimit të Shoqatës Ndërkombëtare të Grave Police (IAWP) që u zhvillua në Leksington të Kentakit, SHBA, në datat 21-25 gusht. Falë mbështetjes së “UN Women” dhe Programit Ndërkombëtar të Asistencës për Trajnim në Hetimet Penale (ICITAP), dy oficerë të reja policie, Elisabeta Hoxha dhe Edasarela Mustafaraj përfaqësuan Policinë e Shtetit pas një procesi përzgjedhës shumë konkurrues dhe transparent. Konferenca Vjetore e Trajnimit e IWAP-it është aktiviteti kryesor i

Shoqatës të themeluar në vitin 1915, që tani numëron anëtarë nga 55 shtete dhe koordinatore në 18 rajone IAWP. Ky eveniment madhështor mbledh profesionistë ndërkombëtarë që merren me zbatimin e ligjit dhe konsiderohet një mundësi trajnimi unike për oficeret policore nga mbarë globi.

Përveç trajnimeve, Konferenca është një mundësi e shkëlqyer për të shkëmbyer informacion dhe kontakte me kolegët e tjerë nga mbarë bota, duke shërbyer si shkëndijë për projekte dypalëshe dhe shumëpalëshe. Pjesëmarrja e oficerëve të Policisë së Shtetit në këtë konferencë është mundësuar në kuadrin e mbështetjes së gjerë që “UN Women” dhe donatorë të tjerë po i japin Shqipërisë për zbatimin e një Plani Veprimi ambicioz për rritjen e nivelit të përfaqësimit të grave në polici. Aktualisht, femrat përfaqësojnë rreth 9.55% të numrit total të punonjësve në Policinë e Shtetit, ku vetëm 530 nga 913 fem-

ra mbajnë gradë policie. Për momentin, po zhvillohet një fushatë rekrutimi vetëm për kandidatët femra, ndërkohë që pas një procesi të gjerë konsultativ dhe disa tryezash të rrumbullakëta, janë miratuar ndryshime në rregullore që favorizojnë punësimin e femrave në Policinë e Shtetit.

Të mësosh për Buxhetimin Gjinor në Austri

Më 13-15 shtator 2011, në kuadrin e Programit Rajonal për Politikën Gjinore, UN Women Albania në bashkëpunim të ngushtë me Agjencinë Austriake për Zhvillim (ADA), organizoi një vizitë studimore 3-ditore në Vjenë të Austrisë për nëpunësit shtetërorë nga Ministria e Financës, Ministria e Brendshme, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve

të Barabarta, si edhe të përfaqësuesve të Departamentit të Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndhmës së Huaj. Objektivi i vizitës studimore ishte shkëmbimi i përvojës dhe përballja me raste konkrete austriake, për të parë instrumentet e futjes së dimensionit gjinor në politika dhe buxhete, duke përdorur mjetet dhe metodologjitë e Politikave Përgjegjëse Gjinore (GRP).

Austria është i pari vend evropian që futi Politikën Përgjegjëse Gjinore në Kushtetutë (2009), si edhe në Aktin Federal të Buxhetit që hyn në fuqi në vitin 2013. Në takime të ndryshme me përfaqësues të Qeverisë austriake (Kancelarinë Federale, Ministrinë e Financave, Ministrinë për Gratë dhe Shërbimin Civil, Departamentit të Politikave Tatimore dhe Legjislacionit Tatimor, Drejtorisë së Statistikave të Popullsisë dhe Statistikave Sociale, Departamentit të Grave në Bashkinë e Vjenës, Ministrinë Federale të Punës, Çështjeve Sociale dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe në selinë e Agjencisë Austriake për Zhvillim), delegacioni shqiptar pati mundësinë të njihet nga afër me GRP-në dhe reformën buxhetore, me mekanizmat e zbatimit dhe monitorimit të buxhetimit gjinor, me sistemin e menaxhimit të cilësisë dhe me fushatat informuese në nivel vendor. “Vizita ishte shumë e vlefshme për të parë konkretisht se si Qeveria austriake prioritetizojnë çështjet gjinore në formulimin e buxhetit”, theksoim znj. Iva Zajmi, zv.Ministre e Ministrisë së Brendshme. Si rezultat i kësaj vizite, u krijua një grup pune nën drejtimin e MPCSSH-së që të bëjë hapa konkretë për të vlerësuar se deri në ç’masë përvoja austriake është e zbatueshme dhe e replikueshme në Shqipëri. UN Women investon prej kohësh për promovimin e Buxhetimit Gjinor në Shqipëri, duke ndihmuar autoritetet qendrore dhe vendore përmes përhapjes së praktikave më të mira, trajnimeve dhe asistencës teknike. Buxheti Gjinor është një qasje që garanton jo vetëm përfitime të barabarta për meshkujt dhe femrat nga burimet publike, por promovon barazinë gjinore në mënyrë më sistematike dhe sistematike.

OSBE-ja organizon shkollën verore për gratë në qeverisje

Projekti “Rritja e Rolit të Grave në Qeverisje” i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri organizoi në Durrës, në datat 12-14 Shtator 2011, një shkollë verore për gratë e zgjedhura si këshilltaret bashkiake dhe komunale në zgjedhjet vendore të 8 Majit. Në këtë veprimtari morën pjesë më shumë se 70 gra këshilltaret nga mbarë vendi dhe nga të gjitha krahët e spektrit politik.

Falë shkollës verore, këshilltaret patën një mundësi të mirë për të përvetësuar aftësi të reja



Foto: Vizitë studimore 3-ditore në Vjenë të Austrisë për nëpunësit shtetërorë, organizuar nga UN Women Albania në bashkëpunim të ngushtë me Agjencinë Austriake për Zhvillim



si dhe për të ndarë me njëra-tjetrën përvojat dhe mësimet e fituara. Kjo nisje kishte për synim të rriste aftësitë e pjesëmarrësve për të ushtruar mandatet e tyre si dhe për t’u siguruar atyre instrumentet e nevojshme për integrimin gjinor në politikat vendore me qëllim ofrimin e shërbimeve publike optimale komuniteteve lokale. Kurset u zhvilluan nën drejtimin e një ekipi trajnerësh ndërkombëtarë e vendas, të asistuar nga personeli i Prezencës si dhe nga persona me përvojë në këtë fushë, përfshirë këtu këshilltaret vendase më përvojë që përfaqësonin parti të ndryshme politike dhe që kishin shërbyer në këtë post për disa mandate radhazi.

“Për sa i përket rritjes së pjesëmarrjes të grave në jetën publike dhe politike, një sfidë e vazhdueshme mbetet ndryshimi i qëndrimit të partive politike dhe strukturave të tyre drejtuese të mbizotëruara nga meshkujt, si dhe ngritja e kapaciteteve të përfituesve,” tha Ambasadori Eugen Wollfarth, Kryetari i Prezencës së OSBE-së. “Për të arritur përfaqësim domethënës gjinor në të gjithë organet legjislativë, gjyqësore dhe ekzekutive nevojitet një zbatim më i mirë dhe mundësisht ndryshime të Kodit Zgjedhor dhe të legjislacionit përkatës, përpara zgjedhjeve parlamentare të vitit 2013.”

“Rritja e Rolit të Grave në Qeverisje” është një projekt 3-vjeçar që përfundon në muajin Dhjetor të këtij viti. Është një projekt që po implementohet nga Prezenca i financuar nga Ambasada e Mbretërisë së Holandës dhe Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA).

Festivali Ndërkombëtar i Filmit për të Drejtat e Njeriut

Gjatë datave 25-30 shtator 2011, Shkolla e Filmit “Marubi” organizoi edicionin e gjashtë të Festivalit Ndërkombëtar të Filmit për të Drejtat e Njeriut. Gjatë këtyre viteve, Festivali është shndërruar në institucion. Më tepër sesa shfaqja e filmave, festivali është eveniment i rëndësishëm për avancimin e të drejtave të njeriut. U krijuan forume speciale që studentët të diskutojnë me ekspertët në lidhje me çështjet e të drejtave të njeriut. Të pranishëm ishin edhe shumë regjisorë të filmave të shfaqur, që të flisnin rreth filmave. Mbështetje donatore për Festivalin e Filmit ka ardhur në rritje, përfshi mbështetjen e institucioneve dhe shoqërive tregtare shqiptare. “Shumë çështje të përditshme janë çështje të të drejtave të njeriut. Edhe nëse nuk janë, mund të bëhen çështje të të drejtave të njeriut, në varësi të mënyrës që zgjedhim për t’i zgjidhur. Filmat e zgjedhur na ndihmojnë për të kuptuar dimensionet e të drejtave të njeriut në kontekstin e shumë çështjeve globale apo private. Ato tregojnë dhimbjen, agoninë, vuajtjen e fëmijëve, grave dhe burrave që janë bërë viktime për arsye përtej kontrollit të tyre. Filmat ndihmojnë ta shohim realitetin nga një objektiv tjetër. Ato na japin një sens më

të mprehtë të drejtësisë, ndershmërisë dhe të drejtave, që ne të gjejmë zgjidhje më të mira. “Shpresoj që të provokojnë debat”, tha në fjalën e hapjes Detlef Palm, Përfaqësues i UNICEF-it dhe Kryetar i Bordit të IHRFFA-s.

Avokati i të Drejtave të Njeriut, z. Robert Badinter, viziton Shqipërinë për të analizuar sistemin e Drejtësisë për të Miturit

Me mbështetjen e UNICEF-it, ish-Ministri i Drejtësisë i Francës dhe avokati i mirënjohur i të drejtave të njeriut, z. Robert Badinter, zhvilloi një vizitë në Shqipëri në datat 12-14 tetor 2011, me qëllim promovimin e respektimit të të drejtave të të miturve në burg. Ai vizitoi qendrat e burgimit në Tiranë, Lezhë dhe Kavajë, dhe u takua me aktorë kyç qeveritarë dhe joqeveritarë të sistemit të drejtësisë për të miturit. Z. Badinter lavdëroi Qeverinë shqiptare për progresin e bërë në humanizimin e sistemit të drejtësisë. Gjatë takimit me Kryeministrin Sali Berisha, z. Badinter dha disa rekomandime kyçe për konsolidimin e masave edukative për fëmijët nën moshën 14 vjeç që janë në konflikt me ligjin, për shkurtrimin e afatit të paraburgosjes së të miturve, dhe për nevojën e shërbimeve të punës sociale dhe të masave edukative për të gjithë fëmijët të privuar nga liria.

Takim i përgjegjësve për të Drejtat e Fëmijëve në bashki dhe këshilla qarku

Më 21 tetor 2011, Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, në kuadrin e nismës së Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe me



Foto: Edicioni i gjashtë i Festivalit Ndërkombëtar të Filmit për të Drejtat e Njeriut

mbështetjen e UNICEF-it, organizoi një takim të strukturave vendore nga e gjithë Shqipëria. Në takim morën pjesë përgjegjës të Njësive për të Drejtat e Fëmijëve në këshilla të qarkut, punonjësit socialë në bashki dhe komuna dhe përfaqësues të Ministrisë. Folësit në takim theksuan rolet e ndryshme dhe përgjegjësitë e aktorëve kryesorë në nivel vendor, rajonal dhe kombëtar, për zbatimin e Ligjit Nr. 10347, datë 4.11.2010 “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve”. Z. Spiro Ksera, Ministër i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta bëri thirrje për forcim të kapaciteteve institucionale në nivel rajonal dhe vendor në lidhje me monitorimin, raportimin dhe realizimin e të drejtave të fëmijëve. Ai inkurajoi nëpunësit publikë që të jenë më aktivë në zbatimin e kompetencave shtesë që u jep ligji i ri, dhe të parashikojnë shërbimet e mbrojtjes së fëmijëve në buxhetet e tyre vendore. Z. Detlef Palm, Përfaqësues i UNICEF-it, shpjegoi rolin plotësues të mekanizmeve të ndryshëm të të drejtave të njeriut, në garantimin e shërbimeve më të efektshme për fëmijët. Znj. Miranda Pashaj, kryetare e Agjencisë Kombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, përshkroi detyrat specifike

dhe përgjegjësitë e punonjësve të mbrojtjes së fëmijëve në nivel kombëtar, rajonal dhe vendor, fluksin e informacionit dhe strukturën e Agjencisë. Ajo ftoi të gjithë pjesëmarrësit që të mbrojnë të drejtat e fëmijëve si përgjegjësi sociale, institucionale dhe qytetare e të gjithëve.

OSBE-ja kontribuon për të përmirësuar mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve

Më 11 tetor 2011, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri në bashkëpunim me Bashkinë e Elbasanit organizoi të parin nga një seri prej 10 seminaresh trajnuese për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Objektivi i seminareve është që të promovohen të drejtat e fëmijëve si dhe të sigurohet mbrojtje më efektive e tyre në nivel vendor. Mësues, psikologë, mjekë familjeje dhe punonjës policie që morën pjesë në këto trajnime ndërdisiplinore, u njohën me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës dhe mësuan më tepër rreth Njësive për Mbrojtjen e Fëmijëve të ngritura në nivel vendor.

“Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijëve që po ngrihen në mbarë vendin përbëjnë një gur themeli në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve. Shpresojnë se ato do të kthehen në një simbol bashkëpunimi dhe koordinimi të mirë mes të gjitha grupeve të angazhuara në mbështetjen, mbrojtjen dhe udhëheqjen e fëmijëve,” tha Ambasadori Eugen Wollfarth, Kryetar i Prezencës së OSBE-së. “Këto Njësi duhet të bëhen gjithnjë e më të dukshme si dhe të fuqizohen për të shërbyer si fanar ndriçues për të gjithë fëmijët që kanë nevojë për këshilla, për të gjitha familjet që kanë nevojë për mbështetje, si dhe për gjithë të tjerët që i bashkojnë forcat në mbrojtje të fëmijëve si një nga kategoritë më të pambrojtura dhe më të pafavorizuara të shoqërisë sonë”.

Seminaret trajnuese zhvillohen në



Foto: Vizita në Shqipëri e ish-Ministrit të i Drejtësisë të Francës dhe avokatit të të drejtave të njeriut, z. Robert Badinter



■ Foto: Trajnim i personelit penitenciar për të miturit i zhvilluar nga UNICEF

kuadrin e veprimtarive më të gjera të Prezencës që synojnë të fuqizojnë kapacitetet e Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijëve. Ky projekt po zbatohet falë mbështetjes së Qeverisë franceze e cila prej shumë vitesh ndihmon në zbatimin e projekteve në fushën e mbrojtjes së fëmijëve në Shqipëri.

Trajnim i personelit penitenciar për të miturit

Në partneritet me Komitetin Shqiptar të Helsinkit dhe ekspertë të sistemit penitenciar holandez, UNICEF mbështeti trajnimin e personelit që merret me të miturit në institutet e vuajtjes së dënimit në një aktivitet të zhvilluar në Durrës, në datat 23 deri 27 tetor 2011. Programi ishte ideuar për të rritur kapacitetet profesionale kryesisht të personelit që punon në institutin e të mi-

turve në Kavajë. Grupi i përzier me 40 punonjës të shërbimeve sociale dhe efektivë të burgjeve, u trajnuan në lidhje me: Teknikat e *feedback*-ut që përdoren me të rinjtë dhe kolegët; Ndëhryrjet konjitive pedagogjike duke përdorur metoda gjerësisht të testuara; Konsultimi kolegjal me kolegët gjatë punës me të miturit; Zhvillimi i detyrave të këshillimit; dhe Qëllimet e trajtimit të të miturve dhe si hartohet plani për rehabilitimin dhe ri-integrimin.

Panairi i Rrugës në Tiranë kremton 20-vjetorin e ringjalljes së miqësisë mes popullit të Shteteve të Bashkuara dhe të Shqipërisë

Lidhjet e forta diplomatike mes Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara u kremtuan kremtuan në Tiranë më 1 tetor, 2011,



■ Foto: Panairi i Rrugës në Tiranë kremton 20-vjetorin e ringjalljes së miqësisë mes popullit të Shteteve të Bashkuara dhe të Shqipërisë

Fotografi zviceran prezanton Librin dhe Ekspozitën me Fotografi për Tranzicionin e Shqipërisë në këto 20 vjet

Me mbështetjen e Zyrës së Bashkëpunimit Zviceran, një libër i ri dhe ekspozitë fotosh u lançuan më 22 tetor 2011, të cilat përshkruajnë ndryshimet dhe tranzicionin e Shqipërisë të kapura në foto nga fotografi zviceran, Hans Peter Jost. Një libër dhe ekspozitë fotosh u paraqitën para medieve dhe publikut më 22 tetor 2011, gjatë një evenimenti të organizuar nga Zyra e Bashkëpunimit Zviceran në kuadrin e festimit të 15-vjetorit të saj në Shqipëri. Me temën "Shqipëria në Tranzicion 1991", libri dhe ekspozita me të njëjtin titull tregojnë aspekte të ndryshme të shoqërisë dhe jetës shqiptare të kapura nga objektivi i fotografit Hans Peter Jost, mes viteve 1991 dhe 2011. Libri përmban shënime nga Christina Kleineidam dhe një parathënie nga Fatos Lubonja.

Autorët së bashku me zv. Drejtoreshën e Zyrës



■ Foto: Prezantimi i librit dhe i ekspozitës me titull: "Shqipëria në Tranzicion 1991", e mundësuar me mbështetjen e Zyrës Zvicerane për Bashkëpunim në Shqipëri. Ekspozita qëndroi e hapur nga 22 tetori derimë 6 nëntor.

së Bashkëpunimit Zviceran, znj. Anne Savary, prezantuan librin dhe fotot para një audience me përfaqësues nga media, misionet diplomatike dhe dashamirës të kulturës. Evenimenti u organizua tek Tirana Ekspres Art Space, një sallë kulturore e ndërtuar mbi një magazinë të vjetër që daton nga koha e komunizmit. "Fotot në këtë libër dhe ekspozitë tregojnë një histori të qartë mbi rugëtimin e Shqipërisë në 20 vitet e fundit", tha znj. Savary. "Ato ushqejnë reflektimin dhe na lënë me një ndjesi qartësie, përluljeje, ndërgjegjësimi dhe mësimi", vazhdoi znj. Savary, duke shtuar se Bashkëpunimi Zviceran e financoi këtë libër në kuadrin e rritjes së vetëdijes dhe shijlles në ndërgjegjen kolektive të çështjeve të lidhura me zhvillimet e Shqipërisë në 20 vitet e fundit. Shkrimtari dhe publicist Fatos Lubonja mbylli fjalimet prezantuese duke përshkruar historitë që përmbanin fotot dhe duke përmendur se Shqipëria ka bërë përparim nga "heshtja" e ditëve të para pas rënies së komunizmit, por tani ajo përballlet me sfida të reja. Bashkëpunimi Zviceran e ka mbështetur Shqipërinë në 15 vitet e fundit në përpjekjet drejt demokracisë dhe integritetit evropian. Publikimi i "Shqipëria në Tranzicion 1991" synon të prezantojë arritjet dhe sfidat e kalimit nga një shoqëri totalitare dhe e izoluar, në një shoqëri demokratike.

me një panair rruge të organizuar nga Ambasada Amerikane, Bashkia e Tiranës dhe Qeveria e Shqipërisë, për të shënuar 20-vjetorin e rihapjes së Ambasadës së SHBA pas më shumë se 50 vjetësh. Festimet që u hapën nga kryetari i bashkisë së Tiranës, Lulzim Basha, dhe Ambasadori amerikan Arvizu, përfshinë numra muzikorë amerikanë dhe shqiptarë praninë e Dajë Semit dhe Zonjës së Lirisë, kioska interaktive që promovonin USAID-in dhe punën e programet e agjencive të Qeverisë amerikane. Argëtimet e tjera përfshinin karaokën, pikturimin e fytyrës dhe tatuazhet. Rreth 10.000 vizitorë ishin të pranishëm në këtë aktivitet, dhe pothuaj të gjitha mediet e mëdha e paraqitën atë me transmetime live dhe me kronika gjatë gjithë ditës.

Ambasada e SHBA në Tiranë u rihap zyrtarisht më 1 tetor 1991.

Për të parë fotot nga Panairi i Rrugës, mund të vizitoni faqen e Ambasadës në Facebook:

<http://www.facebook.com/usembassytirana>

Shpallen rezultatet paraprake të studimit për ndihmën sociale

Më 29 shtator 2011 u shpallën rezultatet paraprake të Anketës Kombëtare "Reforma e ndihmës sociale: Nga mbijetesa të investimet për uljen e varfërisë", të realizuar nga Instituti i Kërkimeve Urbane dhe Qendra Kombëtare për Studimet Sociale, me porosi të UNICEF-it. Qëllimi i studimit është të kuptohen më mirë dimensionet ekonomike dhe sociale të varfërisë së fëmijëve; vlerëson efektshmërinë e ndihmës sociale, se sa arrin të plotësojë nevojat bazë të fëmijëve; dhe jep rekomandime për programe dhe politika që u mundësojnë fëmijëve nga prindër të varfër të jenë të shëndetshëm, të mësojnë dhe të zhvillohen si fëmijët e tjerë. Studimi konstaton se sistemi aktual i ndihmës së huaj ofron benefite "ekonomike" dhe jo "sociale" për fëmijët. Ndihma sociale ka pak efekt në ndjekjen e shkollës, apo në shëndetin dhe ushqyerjen e fëmijëve, si edhe nuk i ndihmon ata t'i shpëtojnë grackës së varfërisë.

Me këtë nismë, UNICEF mbështet reformën e qeverisë për të ndryshuar programin e ndihmës sociale që ta bëjë efektive për fëmijët. Konstatimet e studimit theksojnë se varfëria duhet të zbutet jo vetëm me ndihmë monetare, por duke i shpërndarë edhe në sektorët si arsimit dhe shëndetësia.

Misionet në vend

Nisma e Fortifikimit të Miellit (FFI) – Misioni i avokatisë

Eksptertë nga Nisma e Fortifikimit të Miellit (FFI) dhe Zyra Rajonale e UNICEF-it në Gjenevë, vizituan Shqipërinë gjatë periudhës 17-21 tetor 2011. Ata u takuan me aktorët kryesorë të fushës, përfshi përfaqësues të Institutit të Shëndetit Publik, Ministrisë së Shëndetit, Ministrisë së Bujqësisë, Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, deputetë, mullixhinj, shoqatat e konsumatorëve dhe median. Takimet dypalëshe dhe të përbashkëta u karakterizuan nga konsensi i gjerë për ekzistencën e mangësisë së hekurit në popullatën shqiptare, si edhe për fortifikimin e miellit si një nga mënyrat më rentabël dhe të qëndrueshme për adresimin e këtij problemi. Përfaqësues të sektorit publik, privat dhe qytetar, do të formojnë një aleancë kombëtare fortifikimi e cila do të mbështetë dhe do të mbikëqyrë të gjithë procesin e fortifikimit të miellit në Shqipëri. Ministri i Shëndetësisë, dr. Petrit Vasili, shprehu angazhimin e vendosur institucional për ta përkrahur këtë nismë, duke u bazuar në përvojën e suksesshme me jodizimin e kripës në Shqipëri. Përfaqësuesi i UNICEF-it, z. Detlef Palm, theksoi se fortifikimi i miellit duhet të konsiderohet si diçka që është në interes të shëndetit publik.

Banka Botërore

Projekti i Propozuar për Modernizimin e Ndihmës Sociale, Misioni Paravlerësues, 31 tetor deri 11 nëntor 2011. Objektivat e misionit ishin: (i) rikonfirmimi i prioritetëve dhe rakordimi mes Qeverisë shqiptare dhe ekipit të Bankës Botërore; (ii) diskutimi i disbursimit sipas të indikatorëve për projektin, harkun kohor, vlerën e disbursimit dhe mjetet e verifikimit; (iii) përcaktimi i fushës së veprimit për dhënie e asistencës teknike që të arrihet disbursimi sipas indikatorëve dhe objektivi i zhvillimit të projektit; (iv) diskutimi i menaxhimit financiar dhe i mjeteve të mbikëqyrjes së kontrollit për programet e Ndihmës Ekonomike dhe Personat me Paaftësi Fizike; (v) përditësimi i informacionit për reformën e sistemit të ndihmës

ekonomike për personat me paaftësi fizike dhe fazat e saj; (vi) formulimi i udhërrëfyesit për zhvillimin e regjistrimit kombëtar; (vii) diskutimi i fushatave informuese për programin e reformave; dhe (viii) shqyrtimi i afateve kohore për përgatitjen e projektit.

Misioni i Mbështetjes së Zbatimit për Projektin e Zhvillimit të Burimeve Natyrore të Shqipërisë, (31 tetor deri 11 nëntor 2011). Objektivat specifikë të misionit ishin: (i) shqyrtimi i ecurisë së zbatimit të aktivitetëve të Projektit të financuara nga Fondi i Besimit i GEF-it (që mbyllet në 1 nëntor, 2011); dhe (ii) miratimi i planeve të zbatimit dhe prokurimit për Fondi e ri të Besimit të SIDA-s për Menaxhimin e Përmirësuar të Burimeve Natyrore.

Vlerësimi i Sektorit Financiar u zhvillua nga 24 tetor deri 1 nëntor 2011. Pas diskutimeve të Bankës Botërore gjatë Takimeve Vjetore për impaktet potenciale të krizës së Eurozonës në sektorin bankar shqiptar, një mision faktmbledhës dhe vlerësues do të vijë për vizitë në Tiranë në datat 24 tetor - 1 nëntor 2011. Ekipi kryesohej nga Michael Edërds, Kryespecialist i Sektorit Financiar dhe përfshin Greta Minxhoxin, Shefe e Operacioneve dhe Erjon Lucin, ekonomist. Ekipi do të takohet me drejtuesit dhe stafin kryesor të institucioneve si: Ministria e Financave, Banka e Shqipërisë, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, Agjencia e Sigurimit të Depozitave, për të diskutuar rreth zhvillimeve aktuale në sektorin bankar, strategjitë potenciale për zbutjen e efekteve të krizës, nevojat fiskale dhe reformat e nevojshme për një kuadër kontingjence që mbron bankat, etj. Ekipi do të ndërveprojë edhe me Institucioneve Ndërkombëtare Financiare (FMN dhe BERZH) dhe me bankat kryesore tregtare në Shqipëri.

Misioni i Mbështetjes së Zbatimit të Projektit Cilësi dhe Barazi në Arsim, u zhvillua në tetor 2011. Gjatë vizitës në Shqipëri, ekipi analizoi progresin e bërë me zbatimin e projektit, si edhe ecurinë

e parashikuar deri në fund të projektit. Fokusi i analizës është të arrihet në një vlerësim të saktë të aktiviteteve që mund të kryhen deri në afatin e mbylljes, që është dhjetori 2011, si edhe të parashikohet se çfarë mund të bëhet në rast shtyrjeje 6-mujore apo 12-mujore. Në këtë kontekst, ekipi do të analizojë progresin në të gjitha fushat prioritare. Ekipi ka hyrë në kontakt me stafin shqiptar për miratimin e një agjende pune. Ekipi do të takohet edhe me firmën Konsulente TA-ALB-10 (financuar nga BE) që asiston Ministrinë në zhvillimin e një “metodologjia vendimmarrjeje për Investimet në Infrastrukturën Arsimor”, që të vlerësohet ecuria e zbatimit të grantit. Studimi i kushteve të godinave shkollore është pranë përfundimit dhe ekipi do të shohë mundësinë për të mbajtur një seminar ku të diskutohen konstatimet paraprake nga të dhënat.

Misioni i Përgatitjes për Projektin e Transportit ndërmorr nga 26 deri më 30 shtator 2011. Objektivat kryesorë të misionit ishin: (i) diskutimi projekt Raportit të Huamarrësve të projektit; (ii) realizimi i vizitave në terrenet e projektit për të parë punimet e projektit; dhe (iii) diskutimi me aktorët kryesorë të sektorit të transportit, për të marrë këndvështrimin e tyre për zbatimin e projektit dhe impaktit të tij në këtë sektor.

Projekti për Përmirësimin e Raportimit Financiar të Korporatave (CFREP) dhe Rruga drejt Evropës: Programi për Reformimin e Kontabilitetit dhe Fuqizimin Institucional (REPARIS) (3-7 tetor 2011): Gjatë misionit, ekipi shqyrtoi ecurinë e zbatimit të masave të rena dakord gjatë misionit të prillit 2011 (përfshi planin e prokurimit, termat e referencës, shpalljen e procedurës së prokurimit për Komponentët 1, 2 dhe 3, dhe aspektet e tjera të menaxhimit të projektit. Ekipi do të informojë homologët shqiptarë për aktivitetet më të fundit rajonale të programit REPARIS. Ekipi do të takohet dhe do të punojë ngushtë me Grupin e Zbatimit të Reformave (RIG) dhe me Njësinë Qendrore të Financimit dhe Kontraktimit pranë Ministrisë së Financave, si edhe me aktorët e tjerë kryesorë si IEKA, Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit dhe Bordi i Mbikëqyrjes Publike.

Misioni i Menaxhimit Financiar të Projektit të Propozuar i Modernizimit të Ndihmës Sociale, u zhvillua nga 26 deri më 30 shtator 2011. Objektivi i vizitës ishte përfundimi i vlerësimit të menax-

himt financiar dhe analizimi i zbatimit të programit të Ndihmës Ekonomike. Gjatë misionit, ekipi do të punojë bashkërisht me departamentet e ndryshme të Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Shërbimit Social Shtetëror si edhe të Thesarit dhe Kontrollit të Lartë të Shtetit me qëllim që: (i) të qartësohen rolet përkatëse të departamenteve përgjegjëse për ekzekutimin e buxhetit, të gjenerohen raporte buxhetore/financiare vjetore dhe të ndërmjetme, të gjenerohet informacion për fluksin e thesarit dhe rakordimin e benefiteve (përfshi benefitet e paguara, të akumuluar, të pambledhura); (ii) analizimi i shpërndarjes së pagesave, kontrollit dhe sigurisë për tërë procesin, si edhe analizimi se si zyrat e thesarit menaxhojnë dhe kapin të dhënat e transakcioneve të pagesave, përfshi testimin dhe procesin e rakordimit për të verifikuar integritetin e të dhënave të raportuara; dhe (iii) përgatitja e një propozimi për auditim dhe mbikëqyrje, që të qartësohet dhe të dallohet roli i ‘inspektimit’ apo i auditit të përputhërisë (ministra) kundrejt rolit të auditit të performancës dhe financiare (Kontrolli i Lartë i Shtetit).

Misioni i prokurimit (3-5 tetor 2011): Qëllimi i misionit ishte: (i) diskutimi i çështjeve të prokurimit për operacionet e financuara nga Banka me agjencitë përkatëse shtetërore; dhe (ii) forcimi i kapaciteteve të personelit të prokurimit dhe koordinatorëve/menaxherëve të projektit në të gjithë Njësitë e Zbatimit të Projektit. Misioni u takua me

znj. Klodiana Cankja, Kryetare e Agjencisë së Prokurimit Publik, për të diskutuar rreth përgatitjeve për Forumin e tetë të Prokurimit që do të mbahet në Shqipëri në maj 2012, me temë prokurimin elektronik.

Projekti për Përballimin dhe Zbutjen e Rrezikut nga Fatkeqësitë Natyrore, Asistencë Teknike për Fuqizimin e Menaxhimit të Rreziqeve nga Përmbytjet (3-7 tetor 2011): Qëllimi i misionit ishte diskutimi me homologët e qeverisë për progresin e arritur në zbatimin e projektit, arritjet e tij të deritanishme dhe masat e rena dakord në misionin e mëparshëm të majit 2011. Ekipi dëshiron të diskutojë edhe me agjencitë përkatëse për aktivitetet e prapambetura të projektit, afatet kohore për përfundimin e tyre dhe rezultatet e pritshme duke pasur parasysh se po afron data e mbylljes së projektit, që është 28 shkurti 2011. Në fund, ekipi i Bankës dhe agjencitë shtetërore do të shqyrtojnë progresin dhe një plan me hapa për asistencën teknike në mbështetje të menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet në basenin e lumit Drin-Buna, i financuar nga granti i (GFDRR).

Projekti për Burimet Ujore dhe Vadtjen, Misioni i Përgatitjes së Projektit (29-30 shtator 2011): Misioni diskutoi progresin e bërë në përgatitjen e projektit dhe në huat për reformat në politikat e zhvillimit të sektorit social, me qëllim zgjidhjen çështjeve të akumuluar që mund të ndikojnë negativisht në përgatitjen në kohë të projektit.

dialoguqeveridonatorë

Nga data 1 korrik 2011, USAID mori Kryesimin e Sekretariatit Teknik të Donatorëve nga Banka Botërore

Të gjitha komentet lidhur me Dialogun Qeveri-Donatorë janë më se të mirpëritura!

Doni të kontribuoni?

Nëse dëshironi të kontribuoni, dërgoni tekstin tuaj në zyrën e Sekretarit Teknik të Donatorëve (nevila.como@aidharmonisation.org.al) ose në Departamentin e Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj (koordinimi@km.gov.al) deri më datë 5 të çdo muaji. Teksti duhet të jetë mundësisht rreth 100 fjalë.

Shpërndarja:

Çdo botim do t’ju dërgohet më datë 15 të çdo muaji.

Cilët janë donatorët në Shqipëri?

Për të zbuluar cilët janë donatorët që operojnë në Shqipëri, klikoni [këtu](#).

Për t’u çregjistruar:

Lutemi dërgoni e-mail tek Nevila Çomo (nevila.como@aidharmonisation.org.al)

OSCE Buletini Dialogu Qeveri Donatorë mbështetet nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri

